



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPIAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 3 dhe 4 Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.05.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË
BASHKËSI –KKSb-së

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarit të KKSb-së

Me këtë Vendim, zëvendësohet anëtari i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi Z. Milazim Sadiku nga këshilli i prindërve, në numrin rendor 15 të nenit 1 të Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSb në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-6049 të datës 31.01.2022 dhe në vend të tij caktohet Z. Faton Mejzinolli, në Lipjan i cili është zgjedhur në Kuvendin Zgjedhor të Këshillit të Prindërve të Komunës (KPK) mbajtur me datë 18.03.2022.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSb-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSb në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-6049 të datës 31.01.2022 .

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

15 Nr. 020/02-28100

Lipjan, më 31.05.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

